



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 36

26.01.2021

Podujevë

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.90/2010) nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në komunat e Kosovës nr. 03/L-068, nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik :

KONKURS
për plotësimin e vendeve të punës

1. **4 (katër) mësues /e klase në ShFMU të komunës së Podujevës, deri sa të kthehen punëtorët nga pushimi i lehonisë**
2. **Një edukatore për parashkollor, deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë**
3. **Një mësuesimdhënëse të edukatës qytetare, (15 orë në javë) deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë**
4. **Një mësuesimdhënëse të lëndës të edukatës fizike, deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë**
5. **Një mësuesimdhënëse të gjuhës gjermane, deri sa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë**
6. **Një mësuesimdhënëse për lëndët e mjekësisë në SHMLE “ Isa Boletini “ Podujevë**

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

Formulari i aplikimit i plotësuar(merret në komunë - Qendra për shërbime me qytetarë

Rezymeja personale (CV)

Dokumenti personal(letërnjoftim ose pasaportë)

Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh.**

Certifikata që nuk jeni nën hetime

Dëshmi të përvojës në institucione arsimore **(nëse ka).**

I. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar(Ligji nr.02/L-52,Ligji nr. 03/L-068 dhe Ligji nr.04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet administrative përkatëse të MASHT-it ,UA nr.10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për mësues/e klase**
- Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- Fakulteti i Mësuesisë

- **Kriteret e kualifikimit për edukatore**
 - Fakulteti i Edukimit – programi parashkollor
 - Shkolla e Lartë Pedagogjike - drejtimi për edukatore
 - Fakulteti Filozofik – dega e pedagogjisë së përgjithshme
 - Fakulteti i Shkencave Sociale – programi përkujdesja dhe mirëqenia e fëmijëve
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës të edukatës qytetare**
 - Programi/dega: histori – edukatë qytetare/ gjeografi – edukatë qytetare
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit 300 ECTS
 - Sistemi katërvjeçar
 - Baçelor katërvjeçar 240 ECTS
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës të edukatës fizike**
 - Niveli master arsimor– Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
- **Kriteret e kualifikimit – Gjuhë Gjermane:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës për lëndët e mjekësisë**
 - Fakulteti i Mjekësisë - mjek / specialist

Të gjithë kandidatët e kualifikuar për nivelin master arsimor 300 ECTS nga njësitë e tjera akademike, para datës 10.07.2015, i plotësojnë kriteret për tu përfshirë në procesin e rekrutimit.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kriterë :

Njohuritë e përgjithshme 25 pikë

Aftësitë e përgjithshme dhe personaliteti 35 pikë, dhe

Njohuritë profesionale 40 pikë ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të për zgjidhen në pozitat e lartcekura.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuarat diplomat nga MASHT.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e komës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (konkurset).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

• Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (26/01/2021 - 09/02/2021).

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për shërbime me qytetarë, në objektin e ri të Komunës.

Vërejtje : Pas aplikimit kandidatët të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.



u.d. drejtori

Avni Fetahu